



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 3 nën paragrafët 3.2 dhe 3.6 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe nenit 53 dhe 57 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vepruar në kuadër të kompetencave të tij për shfuqizimin dhe ndryshimin e akteve administrative, pas shqyrtimit dhe rivlerësimit të tarifës së mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës) dhe dokumentacionit administrativ dhe tarifor të lëndës, me datën 23.04.2026, nxjerr këtë:

### VENDIM

Për ndryshimin e Urdhëresave Tarifore të Shërbimeve (UTSH) të datës 31.12.2025

1. NDRYSHOHET duke e fshirë në tërësi paragrafin 5 (tarifa e mbi-ngarkesës) të urdhëresave tarifore të shërbimeve, të miratuara të gjitha më datën 31.12.2025, me efekt nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si në vijim:
  - 1.1. ARRU/UTSH-18/01/2026, e miratuar me vendimin nr. 919/D;
  - 1.2. ARRU/UTSH-18/02/2026, e miratuar me vendimin nr. 923/D;
  - 1.3. ARRU/UTSH-18/03/2026, e miratuar me vendimin nr. 921/D;
  - 1.4. ARRU/UTSH-18/04/2026, e miratuar me vendimin nr. 920/D;
  - 1.5. ARRU/UTSH-18/05/2026, e miratuar me vendimin nr. 922/D;
  - 1.6. ARRU/UTSH-18/06/2026, e miratuar me vendimin nr. 926/D;
  - 1.7. ARRU/UTSH-18/07/2026, e miratuar me vendimin nr. 925/D.
2. Urdhëresat tarifore të shërbimeve të ndryshuara i bashkëngjiten këtij vendimi dhe hyjnë në zbatim nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si në vijim:
  - 2.1. ARRU/UTSH-18/01/04-2026;
  - 2.2. ARRU/UTSH-18/02/04-2026;
  - 2.3. ARRU/UTSH-18/03/04-2026;
  - 2.4. ARRU/UTSH-18/04/04-2026;
  - 2.5. ARRU/UTSH-18/05/04-2026;
  - 2.6. ARRU/UTSH-18/06/04-2026;
  - 2.7. ARRU/UTSH-18/07/04-2026.
3. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndalohet faturimi, ri-faturimi, arkëtimi, përfshirë arkëtimi i faturave e pa paguara, si dhe përfshirja në kontrata, lista tarifore apo dokumente të tjera komerciale nga ana e ofruesve të shërbimeve, për çdo konsumator, e tarifës së mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës), të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se, në bazë të nenit 4 paragrafi 3 nën paragrafët 3.2, 3.3 dhe 3.6 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

(ARRU), në ushtrimin e kompetencave të tij ligjore për rregullimin dhe miratimin e tarifave, ka për obligim të sigurojë që tarifat e aplikuar të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të përballeshme për konsumatorët, si dhe proporcionalisht të justifikuar dhe të balancuara me nevojën për qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve.

Në zbatimin praktik të tarifës së mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës), janë evidentuar, paqartësi të theksuara në interpretim dhe aplikim, mungesë e njëtrajtshmërisë në zbatim nga ofruesit e shërbimeve, dhe ankesa të shumta nga konsumatorët lidhur me barrën financiare të krijuar nga kjo tarifë.

Këto paqartësi dhe praktika jo të unifikuara cenojnë parimet themelore të transparencës, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë të palëve, si dhe ndikojnë negativisht në besimin e publikut ndaj sistemit tarifor.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij rregullatore, ARRU ka kryer një rivlerësim të zbatimit të kësaj tarife, duke analizuar ndikimin ekonomik tek konsumatorët, si dhe nevojën për qartësi, dhe uniformitet në zbatimin e saj.

Nga ky rivlerësim rezulton se aplikimi i mëtejshëm i tarifës së mbi-ngarkesës, në formën aktuale, nuk siguron një zbatim të drejtë, të qëndrueshëm dhe të kuptueshëm për të gjitha palët, për çka paraqitet nevoja për rishikim të mëtejshëm në aspektin rregullator.

Në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organet publike janë të obliguara të veprojnë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe brenda kufijve të kompetencave të tyre, si dhe të ushtrorjnë diskrecionin vetëm për arritjen e qëllimit për të cilin ai është dhënë. Po ashtu, çdo veprim administrativ duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë i domosdoshëm, i përshtatshëm dhe jo disproporcional në raport me qëllimin e ndjekur.

Në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organet publike janë të obliguara të veprojnë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe brenda kufijve të kompetencave të tyre, si dhe të ushtrorjnë diskrecionin vetëm për arritjen e qëllimit për të cilin ai është dhënë (neni 4). Po ashtu, çdo veprim administrativ duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit (neni 5).

Në këtë kuadër, organi publik është i autorizuar të veprojë sipas detyrës zyrtare për mbrojtjen e interesit publik (neni 83), ndërsa përfundimi i procedurave të tilla mbetet në diskrecionin e ligjshëm të tij (neni 97). Në bazë të këtyre parimeve dhe kompetencave, organi publik ka të drejtë dhe detyrim të ndërmarrë masa korigjuese në raport me aktet e veta, përfshirë rishikimin ndryshimin apo pezullimin e tyre, kur një veprim i tillë është i nevojshëm për sigurimin e ligjshmërisë dhe funksionimit të drejtë të sistemit rregullator.

Në këtë kontekst, e drejta e ARRU-së për të ndërhyrë në aktet e veta buron nga parimi i vetëkontrollit administrativ dhe përgjegjësia për garantimin e ligjshmërisë në vazhdimësi, si dhe nga detyrimi për të mbrojtur interesin publik dhe për të siguruar një sistem tarifor të zbatueshëm në praktikë.

Për rrjedhojë, në funksion të mbrojtjes së interesit publik, garantimit të një sistemi tarifor të zbatueshëm në praktikë, si dhe sigurimit të balancës ndërmjet përballeshmërisë për konsumatorët dhe qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve, ARRU ka vendosur:

- të fshijë në tërësi paragrafin 5, të urdhëresave tarifore të tarifave të shërbimeve, të cekura në dispozitivin e këtij vendimi;
- të pezullojë përkohësisht aplikimin e tarifës së mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës) në të gjitha dokumentet ku kjo tarifë është vendosur, deri në një vendim tjetër.

Me qëllim të eliminimit të paqartësive të evidentuara në praktikë dhe sigurimit të një zbatimi të njëtrajtshëm dhe transparent të tarifës së mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës), ARRU, do të hartoj një dokument udhëzues. Ky dokument do të përcaktojë në mënyrë të detajuar mënyrën e zbatimit të kësaj tarife, përfshirë: momentin e fillimit të aplikimit të saj, trajtimin e kërkesave për kyçje të paraqitura tek ofruesit e shërbimeve para hyrjes në fuqi të tarifës, përcaktimin e ngarkesave sipas kategorive të konsumatorëve, si dhe çdo element tjetër relevant që ndërlidhet me strukturën, llogaritjen dhe aplikimin praktik të kësaj tarife.

Ky veprim përbën një masë rregullatore të ndërmarrë në kuadër të kompetencave diskrecionare të ARRU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe synon përmirësimin e funksionimit të sistemit tarifor, rritjen e sigurisë juridike dhe mbrojtjen e interesit publik.

Duhet pasur parasysh se, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi, për konsumatorët të cilët janë faturuar për tarifën e mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës), por nuk kanë realizuar pagesën, kjo tarifë nuk do të kërkohet për arkëtim dhe konsiderohet e paaplikueshme. Nga arsyet e cekura më lart, Drejtoresha ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe publikohet në të njëjtën ditë në faqen zyrtare të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

***T'i dërgohet;***

*Ix Arkivit të ARRU,*

*Ix Kryeshefave Ekzekutiv të KRU-ve”*

*Ix Departamenteve të ARRU*





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



REPUBLIC OF KOSOVO  
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit  
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode  
Water Services Regulatory Authority

Nr. prot./Prot. B./ Prot. No. 240  
Mjeshtër/Štaf./Štaf. No. D  
Nr. sh./Ser./Šifra./Ser./Šifra. No. 23-04-2026  
Datë/Date/Šifra

ARRU/UTSH-18/02/04-2026

# URDHËRESË PËR NDRYSHIMIN E URDHËRESËS TARIFORE TË SHËRBIMEVE TË DATËS 31.12.2025

KRU "HIDROREGJIONI-JUGOR" SH. A PRIZREN PËR VITIN 2026

**Qëllimi:** Kjo urdhëresë tarifore ka për qëllim ndryshimin e urdhëresës tarifore të shërbimeve të miratuar më 31 dhjetor 2025, përmes heqjes së dispozitave që rregullojnë tarifën e mbi-ngarkesës (përforcimit të infrastrukturës), me synim sigurimin e një sistemi tarifor më të qartë, transparent dhe të zbatueshëm, si dhe mbrojtjen e interesit publik.

**1. Tarifat fikse dhe volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura**

Kategoria e Konsumatorëve	Njësia	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujësjellësit	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujërave të ndotura
Shtëpiak	EUR/m <sup>3</sup>	0.5680	0.1911
Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	EUR/m <sup>3</sup>	0.7384	0.4205

**2. Tarifa fikse mujore**

Diametri i kyçjes në rrjetin shpërndarës	Njësia	Vlera
Konsumatorët vetëm me lidhje të ujërave të ndotur	EUR/kons/muaj	0.6520
15mm	EUR/kons/muaj	1.3040
20mm	EUR/kons/muaj	1.3040
25mm	EUR/kons/muaj	2.0864
32mm	EUR/kons/muaj	2.0864
40mm	EUR/kons/muaj	8.4500
50mm	EUR/kons/muaj	8.4500
65mm	EUR/kons/muaj	20.8642
80mm	EUR/kons/muaj	20.8642
100mm	EUR/kons/muaj	25.6630
125mm	EUR/kons/muaj	25.6630
150mm	EUR/kons/muaj	40.4765
200mm	EUR/kons/muaj	40.4765
250mm	EUR/kons/muaj	56.3333

3. Tarifat për aktivitetet themelore të lidhjes së konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

3.1 Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Njësia	Vlera
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	EUR/konsumator	10.00

**Shënim:**

1. Pasi që kjo tarifë përfshinë kryesisht shpenzime fikse, atëherë e njëjta shumë (d.m.th. 10 EUR) do të paguhet kur inspektimi: (i) për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, kur ekzistojnë të dyja bashkë; dhe (ii) kur ekziston kërkesa vetëm për njërin shërbim.
2. Kjo tarifë nuk aplikohet kur lidhja e re realizohet nga Kompania, me ç' rast duhet të aplikohet vetëm tarifa: "Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit".
3. Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur lidhja e re realizohet nga kompanitë e autorizuara përmes donacioneve, pasi që tërë projekti (përfshirë edhe lidhjet) i nënshtrohen pranimit teknik.

3.2 Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR)	Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR)	Tarifa totale (lidhja, pusëta, asfaltimi)*** (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	15 mm	80.00	240.00	490.00
	20 mm	80.00	240.00	490.00
	25 mm	100.00	260.00	510.00
	32 mm	140.00	300.00	550.00
	40 mm	180.00	340.00	590.00
	50 mm	370.00	530.00	780.00
	65 & 75 mm	490.00	650.00	900.00
	80 mm	625.00	785.00	1,035.00
	100 mm	780.00	940.00	1,190.00

**Shënim:**

\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

\*\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

\*\*\*Aplikohet në rastet kur gypi i shërbimit gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

### 3.3 Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusetë)* (EUR)	Tarifa e lidhjes (me pusetë, pa asfaltim)** (EUR)	Tarifa totale (lidhja, puseta, asfaltimi)*** (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	160 mm	26.00	153.00	403.00
	200 mm	36.00	163.00	413.00
	250 mm	46.00	173.00	423.00
	315 mm	76.00	203.00	453.00

#### Shënim:

\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusetës)

\*\*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusetës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

\*\*\*Aplikohet në rastet kur puseta gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

### 3.4 Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Njësia	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	EUR/konsumator	10.00

### 3.5 Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Njësia	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	EUR/konsumator	20.00

### 3.6 Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme)

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Njësia	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	EUR/konsumator	10.00

## 4. Tarifat për aktivitetet tjera themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

### 4.1 Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i ujëmatësit	Tarifa për ujësjellës (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	20 mm	16.50
	25 mm	16.50
	32 mm	16.50
	40 mm	18.00
	50 mm	18.00
	63 mm	18.00
	75 mm	19.00
	90 mm	19.00
	110 mm	19.00

**Shënim:** Kjo tarifë aplikohet komfor nenit 28 të Rregullores 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.